



QERSHOR, 2020

UDHËZUES PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PLOTËSUES PËR LËNDËT “GJUHË SHQIPE” DHE “MATEMATIKË” NË KLASAT 1-5

(Në ndihmë të drejtuesve dhe të mësuesve
të shkollave 9-vjeçare)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**UDHËZUES PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PLOTËSUES
PËR LËNDËT “GJUHË SHQIPE” DHE “MATEMATIKË”
NË KLASAT 1-5**

(Në ndihmë të drejtuesve dhe të mësuesve të shkollave 9-vjeçare)

QERSHOR, 2020

**Udhëzues për zbatimin e programit plotësues për lëndët “Gjuhë shqipe” dhe
“Matematikë” në klasat 1-5**

Qershor 2020

Tiranë

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	5
2. Kushtet për zbatimin e programit plotësues	6
2.1. Puna përgatitore për zbatimin e programit plotësues	6
2.2. Mjediset.....	7
2.3. Numri i nxënësve për klasë	7
2.4. Njoftimi i prindërve.....	7
3. Krijimi i klimës mbështetëse dhe bashkëpunuese me fëmijët	7
4. Kohëzgjatja e zbatimit të programit plotësues	8
5. Nxënësit që do të ndjekin programin plotësues.....	9
6. Planifikimi i programit plotësues	10
6.1. Klasa e parë	10
6.2. Klasa e dytë	12
6.3. Klasa e tretë.....	13
6.4. Klasa e katërt.....	14
6.5. Klasa e pestë.....	16
7. Metodologjia për zbatimin e temave mësimore të programit plotësues	17
8. Mjetet mësimore	28
9. Dokumentacioni për frekuentimin dhe arritjet e nxënësve.....	28

LISTA E SHKURTESAVE

MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
SC	Save the Children
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVA	Zyra Vendore Arsimore

1. Hyrje

Mbyllja e institucioneve arsimore si masë parandaluese ndaj përhapjes së COVID-19, ka ndikuar në mënyrën e funksionimit të sistemit arsimor. Kalimi nga procesi mësimor në shkollë në mësimin në kushtet e shtëpisë i përballi mësuesit, nxënësit dhe prindërit me sfida të reja. Gjatë kësaj periudhe, MASR mbështeti mësuesit në përpjekjet e tyre për të zbutur ndikimin e mbylljes së menjëhershme të shkollave, si dhe për të mundësuar vazhdimësinë e procesit mësimor përmes mësimit në distancë (mësimit në kushtet e shtëpisë). Në bashkëpunim me organizatat, bizneset dhe shtëpitë botuese, MASR mundësoi:


- hartimin e udhëzuesve në ndihmë të mësuesve, nxënësve dhe prindërve;
- ofrimin e shërbimit psikologjik për nxënësit;
- trajnimin e mësuesve për përdorimin e platformave online;
- sigurimin e pajisjeve digjitale për fëmijët nga shtresat në nevojë etj.

Falë kësaj mbështetjeje pjesa më e madhe e nxënësve vijoi me realizimin e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula, nëpërmjet mësimit në kushtet e shtëpisë. Megjithatë ka nxënës nga shtresat vulnerabël ose nga zona të thella gjeografike, të cilët nuk mundën ta ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë. Sipas sondazheve të organizuara nga MASR dhe ASCAP, rezultoni që afërsisht 10000 fëmijë nga arsimi parauniversitar nuk kanë marrë pjesë në këtë mësim.

Në një situatë të tillë, MASR dhe ASCAP, në bashkëpunim me Save the Children, kanë hartuar një program plotësues për nxënësit e klasave 1-5, të cilët nuk arritën të ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë gjatë periudhës mars-qershor 2020.

Për të orientuar drejtuesit e shkollave dhe mësuesit rreth procesit të zbatimit të programit plotësues është hartuar *Udhëzuesi për zbatimin e programit plotësues për lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Matematikë” në klasat 1-5*. Udhëzuesi sqaron drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në lidhje me:

- punën përgatitore që duhet të bëjnë shkollat për të zbatuar me sukses programin plotësues;



Udhëzuesi synon jo vetëm të orientojë shkollat, por edhe t'u japë liri dhe fleksibilitet në lidhje me zbatimin e programit plotësues në varësi të kontekstit dhe të rrethanave të tyre.

- krijimin e klimës mbështetëse dhe inkurajuese për fëmijët gjatë zbatimit të programit plotësues;
- kohëzgjatjen e zbatimit të programit plotësues dhe orët mësimore që duhen zhvilluar në lëndën e gjuhës shqipe dhe në lëndën e matematikës;
- planet mësimore për gjuhën shqipe dhe për matematikën, në të cilat janë përcaktuar njohuritë dhe konceptet kryesore lëndore që i përkasin periudhës mars-qershor 2020;
- metodologjinë që mund të ndiqet nga mësuesit gjatë zbatimit të programit plotësues;
- mjetet mësimore që mund të përdoren nga nxënësit;
- dokumentacionin që mësuesit mund të mbajnë për arritjet e nxënësve dhe për frekuentimin e tyre gjatë zbatimit të programit.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e situatës që ka krijuar pandemia COVID-19, ky udhëzues synon jo vetëm të orientojë shkollat, por edhe t’u japë liri dhe fleksibilitet në lidhje me zbatimin e programit plotësues në varësi të kontekstit dhe rrethanave të tyre.

Hartimi i këtij udhëzuesi është realizuar në bashkëpunim me organizatën “Save the Children”, të cilën e falënderojmë për bashkëpunimin.

2. Kushtet për zbatimin e programit plotësues

Fëmijët e arsimit fillor, sidomos ata të klasave të para dhe të dyta, vijnë të ndjeshëm dhe me ndikime nga situata e krijuar nga COVID-19. Edhe pse herë-herë situata normalizohet dhe njerëzit i kthehen rutinës së përditshme, gjithsesi problematikat ende vazhdojnë të shfaqen.

Programi plotësues synon t’u mundësojë nxënësve që për një periudhë 2- javore të jenë pranë mësuesve, shokëve dhe shoqeve të klasës. Që zbatimi i këtij programi të jetë i suksesshëm jo vetëm për arritjet e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe dhe në matematikë, por edhe të ndikojë në mirëqenien psiko-emocionale të tyre, drejtoritë e shkollave dhe mësuesit duhet të krijojnë kushtet e nevojshme në këtë proces.

2.1.Puna përgatitore për zbatimin e programit plotësues

Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me mësuesit e arsimit fillor harton listën e nxënësve, të cilët ose nuk e kanë ndjekur fare mësimin në kushtet e shtëpisë ose e kanë ndjekur pjesërisht atë. Në varësi të numrit të nxënësve, drejtoria e shkollës përcakton mësuesit që do ta zbatojnë programin plotësues. Këta mësues do të trajnohen në lidhje me qëllimet, përmbajtjen dhe metodologjinë e zbatimit të programit plotësues.

Para se të fillojë zbatimi i programit plotësues, shkolla harton një rregullore të thjeshtë dhe të kuptueshme për nxënësit mbi masat e distancimit fizik, ndalimin e veprimtarive që kërkojnë grumbullim të nxënësve, organizimin e nisjes dhe të përfundimit të procesit mësimor, zhvendosjen e klasave nga një mjedis në një tjetër (p.sh., lëvizjen nga klasa në mjediset sportive) dhe njohjen e praktikave të higjienës.

2.2.Mjediset

Për zbatimin e programit plotësues mund të përdoren klasat e shkollës ose edhe mjedise të tjera në shkollë, sipas specifikave të temave mësimore. Në varësi të situatës së pandemisë COVID-19 do të bëhet edhe rregullimi ose përshtatja e mjedisit të klasave. Nëse kjo situatë do të vijojë, atëherë mjedisi duhet të respektojë rregullat e distancimit fizik. Kjo do të thotë që tavolinat të jenë të paktën 1.5 metra larg njëra-tjetrës dhe klasat të krijojnë mundësi për praktikën e higjienës. Lëvizja e nxënësve në mjediset e shkollës duhet të jetë e koordinuar.

2.3.Numri i nxënësve për klasë

Drejtoria e shkollës përcakton klasat që do të zbatojnë programin plotësues. Numri i nxënësve për klasë sugjerohet të mos jetë më shumë se 10 nxënës. Në shkollat, të cilat punojnë me klasa kolektive, numri i nxënësve për klasë mund të jetë edhe më i vogël. Krijimi i klasave kolektive sugjerohet të bëhet duke respektuar shkallët mësimore. P.sh., klasat 1-2 që i përkasin shkallës së parë, mund të formojnë një klasë kolektive. Edhe në shkollat që nuk kanë klasa kolektive, për zbatimin e programit plotësues mund të formohen klasa të tilla, deri në 10 nxënës.

2.4.Njoftimi i prindërve

Shkollat që do të zbatojnë programin plotësues njoftojnë prindërit e nxënësve, të cilët nuk kanë ndjekur mësimin në kushtet e shtëpisë. Prindërit duhet të sqarohen jo vetëm për orarin, por edhe për domosdoshmërinë, qëllimet dhe përmbajtjen kryesore të programit plotësues. Prindërit udhëzohen edhe se si mund të ndihmojnë fëmijët e tyre, në mënyrë që procesi i të nxënësve të vijojë edhe në shtëpi.

3. Krijimi i klimës mbështetëse dhe bashkëpunuese me fëmijët

Gjatë zbatimit të programit plotësues, mësuesit duhet të mbajnë parasysh se nxënësit mund të ndihen ende të stresuar e të frikësuar, të ndiejnë pasiguri dhe vështirësi në rifitim të zakoneve dhe të shprehive përpara pandemisë. Prandaj krijimi i klimës pozitive, mbështetëse dhe të sigurt

do t'i ndihmojë nxënësit ta kalojnë këtë periudhë “mësimi” në nivelin e dëshiruar, me një marrëdhënie të shëndetshme pranë mësuesit dhe nxënësve të tjerë të klasës. Nëse mësuesi ndien dhe kupton se ndonjë fëmijë, me gjithë përpjekjet e bëra ende shfaq shenja izolimi dhe ankthi, atëherë duhet t'i drejtohet shërbimit psiko-social për ta ndihmuar sa më shpejt.

Si prindërit edhe fëmijët duhet të përgatiten psikologjikisht për rikthimin gradual në jetën e mëparshme dhe largimin dalëngadalë nga rutina dhe zakonet e fituara gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë. Kjo periudhë e mësimin për rreth 2 javë është e mjaftueshme për përshtatjen psikologjike të fëmijëve. Gjatë kohës së mësimin *online*, mësuesi komunikonte me nxënësit në pjesën më të madhe të rasteve nëpërmjet telefonave dhe kompjuterëve të prindërve. Edhe në këtë rast ky bashkëpunim duhet të vijojë me qëllim zbutjen e pasojave të mbylljes dhe ruajtjen e shëndetit mendor të fëmijëve.

Mësuesit dhe prindërit duhet t'u flasin fëmijëve për rëndësinë e jetës dhe se gjithsecili duhet ta ruajë veten, duke larë duart dhe duke ruajtur distancën. Gjithashtu, mësuesit dhe prindërit duhet të praktikojnë me fëmijët mënyra të reja të përshtetjes pa u afruar dhe pa u prekur me njëri-tjetrin.

Rifitimi i rutinës së një dite shkolle kërkon kohën e vet dhe për këtë arsye fëmijët duhet të mësohen gradualisht me zgjimin herët, ngrënien e mëngjesit dhe rifillimin e mësimin.

Orët e mësimin në gjuhë dhe në matematikë duhet të ndërthuren me lojën, situatat gazmore, veprimtaritë krijuese, bisedat, tregimet, përrallat, ngjarjet dhe situatat pozitive, këngët, vizatimet, kërcimet, dramatizimet, veprimtaritë sportive, lojërat lëvizore etj.

4. Kohëzgjatja e zbatimit të programit plotësues

Programi plotësues do të nisë të zbatohet dy javë para fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021. Në çdo klasë, përgjatë dy javëve do të zhvillohen gjithsej 40 orë mësimore. Nga këto, 20 orë mësimin janë për lëndën e gjuhës shqipe dhe 20 orë mësimin janë për lëndën e matematikës. Çdo ditë do të zhvillohen 2 orë të gjuhës shqipe dhe 2 orë matematikë. Ora e mësimin do të jetë 45 minuta. Pas zhvillimit të dy orëve të para këshillohet të bëhet një pushim rreth 20- 30 minuta. Gjatë pushimit mund të realizohen veprimtari të ndryshme sportive ose aktivitete të tjera me qëllim çlodhjen dhe argëtimin e nxënësve.

Procesi mësimor mund të fillojë në orën 8.00. Drejtoria e shkollës mund ta spostojë këtë orar në varësi të specifikave dhe të rrethanave që ka shkolla (p.sh., largësia shkollë- shtëpi e nxënësve).

Në çdo klasë, përgjatë dy javëve do të zhvillohen 40 orë mësimore.

20 orë mësimi janë për lëndën e gjuhës shqipe dhe 20 orë mësimi janë për lëndën e matematikës.

Çdo ditë do të zhvillohen 2 orë gjuhë shqipe dhe 2 orë matematikë.

Ora e mësimit do të jetë 45 minuta.

5. Nxënësit që do të ndjekin programin plotësues

Programi plotësues është hartuar për nxënësit nga shtresat në nevojë, të cilët nuk e kanë ndjekur mësimin në kushtet e shtëpisë ose e kanë ndjekur pjesërisht atë. Më konkretisht, në zbatimin e këtij programi mund të marrin pjesë:

- Nxënës që për arsye të ndryshme nuk e kanë ndjekur fare mësimin në kushtet e shtëpisë. Shkolla duhet të angazhohet maksimalisht për përfshirjen e këtyre nxënësve në programin plotësues.
- Nxënës që kanë punuar pjesërisht gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.
- Nxënës që nuk e kanë shqipen gjuhë amtare, p.sh., fëmijë romë.
- Nxënës me nevoja të veçanta. Gjatë zbatimit të programit plotësues mund të angazhohen edhe mësuesit ndihmës për këtë kategori nxënësish.

Nxënës që e nuk kanë ndjekur mësimin në kushtet e shtëpisë.

Nxënës që kanë punuar pjesërisht gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë.

Nxënës që nuk e kanë shqipen gjuhë amtare.

Nxënës me nevoja të veçanta.

6. Planifikimi i programit plotësues

Për t'u ardhur në ndihmë mësuesve që do të zbatojnë programin plotësues, janë përcaktuar temat mësimore për të gjitha klasat dhe në të dyja lëndët. Përcaktimi i tyre është bërë duke marrë parasysh njohuritë dhe aftësitë kryesore në gjuhë dhe në matematikë, të cilat përkojnë me periudhën mars-qershor 2020. Gjithashtu, për përcaktimin e temave janë analizuar të gjitha tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe të matematikës. Në çdo klasë janë përcaktuar 20 tema mësimore për gjuhën dhe 20 tema mësimore për matematikën. Mësuesit *janë të lirë të bëjnë ndryshime apo spostime të këtyre temave në varësi të specifikave dhe të nevojave të nxënësve.*

6.1.Klasa e parë

Abetare

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Përsëritje.
	2.	Punimi i tingullit e shkronjës G, g . Punimi i shkronjës G, g të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	3.	Punimi i tingullit e shkronjës Gj, gj . Punimi i shkronjës Gj, gj të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	4.	Punimi i tingullit e shkronjës Th, th . Punimi i shkronjës Th, th të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	5.	Punimi i tingullit e shkronjës C, c . Punimi i shkronjës C, c të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	6.	Punimi i tingullit e shkronjës Ç, ç . Punimi i shkronjës Ç, ç të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	7.	Punimi i tingullit e shkronjës Nj, nj . Punimi i shkronjës Nj, nj të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	8.	Punimi i tingullit e shkronjës Y, y . Punimi i shkronjës Y, y të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	9.	Punimi i tingullit e shkronjës Z, z . Punimi i shkronjës Z, z të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	10.	Punimi i tingullit e shkronjës X, x . Punimi i shkronjës X, x të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
Java II	11.	Punimi i tingullit e shkronjës Xh, xh . Punimi i shkronjës Xh, xh të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	12.	Punimi i tingullit e shkronjës Zh, zh . Punimi i shkronjës Zh, zh të shtypit dhe të dorës (abetare, fletore pune).
	13.	Pjesë leximi (fabula).

	14.	Përshkruajmë personazhet.
	15.	Pjesë leximi jo letrare (informacion për kafshët).
	16.	Pjesë leximi (përrallë).
	17.	Pjesë leximi (poezi nga poetët shqiptarë).
	18.	Pjesë leximi (tregim nga jeta e përditshme).
	19.	Pjesë leximi joletrare (historiku i zbulimit të një shpikjeje).
	20.	Pjesë leximi (tregim nga jeta e përditshme).

Matematikë

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Krahasimi: më i gjati, më i shkurtri, më i rëndi, më i lehti. Vendndodhja: mbi, në, nën, sipër.
	2.	Figurat simetrike.
	3.	Dyfishimi i numrave njëshifrorë.
	4.	Gjetja e gjysmës së numrave çift me anë të objekteve,
	5.	Ndarja e numrave njëshifrorë në çift dhe tek deri në 10. Ndarja e objekteve në dy grupe të barabarta.
	6.	Gjysma e numrave njëshifrorë me mjete konkrete.
	7.	Konkurs "Veprime me mend duke përdorur dyfishimin.
	8.	Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes.
	9.	Njohja me monedhat nga 10-lekëshe deri në 100-lekëshe.
	10.	Leximi i orës me orë të plota Renditja e ditëve të javës Renditja e muajve të vitit.
Java II	11.	Mbledhja e një numri dyshifror me dhjetëshe të plota me një numër njëshifror pa kalim të dhjetës.
	12.	Mbledhja e 3 numrave njëshifrorë ku dy prej tyre e kanë shumën 10.
	13.	Përdorimi i numrave që kanë shumën 10 si urë për mbledhjen dhe zbritjen e numrave njëshifrorë.
	14.	Kutiza si vendmbajtëse numrash.
	15.	Veprime me mend duke përdorur dyfishimin, përgjysmimin.
	16.	Mbledhja e një numri dyshifror me një numër njëshifror pa kalim të dhjetëshes.
	17.	Dallimi i ligjesisë së një modeli (ngjyra, forma, madhësia). Vazhdimi i një modeli (ngjyra, forma, madhësia).
	18.	Përdorimi i piktogramit. Zbulimi i cilësive të përbashkëta të elementeve të një grupi.
	19.	Grupimi i objekteve sipas dy cilësive të përbashkëta.
	20.	Klasifikimi i sendeve në bazë të dy cilësive.

6.2.Klasa e dytë

Gjuhë shqipe

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Tregim.
	2.	Tregim.
	3.	Numërorët dhe drejtshkrimi i tyre.
	4.	Dallojmë përemrin. Përemri vetor.
	5.	Përralla me elementë fantastikë.
	6.	Përralla me elementë fantastikë.
	7.	Folja <i>kam</i> në kohën e tashme. Folja <i>jam</i> në kohën e tashme.
	8.	Poezi.
	9.	Poezi.
	10.	Foljet hap, vendos, mbjell.
Java II	11.	Foljet ha, pi, fle.
	12.	Diktim.
	13.	Poezi.
	14.	Tregim për udhëtimet.
	15.	Tregim për udhëtimet.
	16.	Shkruajmë mbresat e një udhëtimi.
	17.	Shkruajmë mbresat e një udhëtimi.
	18.	Fjalët me kuptim të afërt ose të njëjtë. Sinonimet. Fjalët me kuptim të kundërt. Antonimet.
	19.	Tekst jo letrar.
	20.	Tekst jo letrar.

Matematikë

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Dyfishi i numrave dyshifrorë. Rrumbullakimi i numrave dyshifrorë me dhjetëshen më të afërt.
	2.	Njohja e numrave rendorë (shumëfishat e dhjetës). Përdorimi i numrave rendorë (të paktën shumëfishat e dhjetës).
	3.	Ndryshesa të vogla të dy numrave dyshifrorë. Dyfishi për numrat më të mëdhenj se 10.
	4.	Pjesëtimi si grupim. Vetitë e pjesëtimit.
	5.	Figurat simetrike. Drejtëza e simetrisë.
	6.	Trupat gjeometrikë <i>kub, kuboid, piramidë, sferë, cilindër, kon</i> .
	7.	Shkrimi i thyesave $1/2$; $1/3$; $1/4$; $2/4$; $3/4$.
	8.	E plotë e shprehur në thyesë $2/2$, $4/4$.
	9.	Thyesa të barabarta.

	10.	Gjysma, çereku, treçereku i figurave ose i një numri objektësh.
Java II	11.	Lëvizja dhe pozicioni. Drejtimi orar dhe kundërorar.
	12.	Leximi i orës me gjysmë orë. Rrotullimi i plotë.
	13.	Rrotullimi i plotë, gjysmë i plotë, çerek i plotë.
	14.	Monedhat. Situata me blerje duke përdorur monedhat.
	15.	Vëllimi i lëngjeve (me njësi standarde litrin). Krahasimi i vëllimit të lëngjeve në enë.
	16.	Vëllimi i lëngjeve (me njësi standarde litrin).
	17.	Vargjet numerike.
	18.	Grafikët në shtyllë.
	19.	Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektësh sipas një ose dy cilësive.
	20.	Piktogramet.

6.3.Klasa e tretë

Gjuhë shqipe

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Poezi.
	2.	Poezi (Teknikë recitimi).
	3.	Tregim.
	4.	Tregim.
	5.	Përemri vetor.
	6.	Foljet në kohën e tashme. Drejtshkrim i foljes në kohën e tashme.
	7.	Tregim për shokun/shoqen time.
	8.	Tregim për shokun/shoqen time.
	9.	Shkruaj për shokun /shoqen time.
	10.	Përdorimi i numërorit në fjali.
Java II	11.	Foljet në kohën e ardhme.
	12.	Folja në kohën e pakryer. Drejtshkrimi i foljeve në kohën e pakryer.
	13.	Përrallë.
	14.	Përrallë.
	15.	Fjalë të urta, gjëgjëza për fëmijë.
	16.	Diktim.
	17.	Tekst jo letrar.
	18.	Tekst jo letrar.
	19.	Përshkruajmë një festë.
	20.	Përshkruajmë një festë.

Matematikë

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Tabela e shumëzimit dhe e pjesëtimit me 2, 3.
	2.	Tabela e shumëzimit dhe e pjesëtimit me 4, 5.
	3.	Tabela e shumëzimit dhe e pjesëtimit me 6, 7.
	4.	Tabela e shumëzimit dhe e pjesëtimit me 8,9,10.
	5.	Njësitë e kohës <i>ora, minuta, sekonda, dita, java, muaji, viti</i> .
	6.	Matja e kohës me 5 minutëshin më të afërt.
	7.	Renditja e ngjarjeve. Kalendarri.
	8.	Figura simetrike. Drejtëza e simetrisë.
	9.	Veprime shumëzimi dhe pjesëtimi me mend me 2-10 brenda tabelës së shumëzimit.
	10.	Vetia e ndërrimit e shumëzimit.
Java II	11.	Shumëzimi i numrave 10-19 me 3 dhe 5.
	12.	Pjesëtimi i numrave dyshifrorë edhe përtej tabelës së shumëzimit.
	13.	Kartëmonedhat deri 1000 lekë. Parashikime të blerjeve deri në 1000 lekë.
	14.	Kombinime monedhash dhe kartëmonedhash që tregojnë të njëjtën vlerë në lekë.
	15.	Pjesa e një numri ose e një figure. Gjysma e numrave çift deri në 40.
	16.	Numrat e përzier. Thyestat e barabarta.
	17.	Njësitë standarde të matjes së vëllimit <i>litri, mililitri</i> . Lëvizja sipas një drejtimi dhe pozicioni i një objekti.
	18.	Rrjeta e katrorëve. Dallimi i ligjësisë dhe vazhdimi i një modeli konkret.
	19.	Grafikët në shtyllë.
	20.	Diagrami i Venit. Piktogramet. Tabela e dendurive.

6.4.Klasa e katërt

Gjuhë shqipe

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Përrallë.
	2.	Përralla (<i>elementet e saj</i>).
	3.	Folja kam/jam (<i>zgjedhimi në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer</i>).
	4.	Folja kam/jam (<i>zgjedhimi në kohën e kryer të thjeshtë</i>).
	5.	Përshkruajmë personazhin që pëlqejmë.
	6.	Përshkruajmë personazhin që pëlqejmë.

	7.	Folja (zgjedhimi në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e kryer të thjeshtë).
	8.	Grupet e fjalëve në fjali. Fjalja më e vogël dhe fjalja e zgjeruar.
	9.	Tregim.
	10.	Tregim.
Java II	11.	Kryefjala(<i>ushtrime</i>).
	12.	Kallëzuesi (<i>ushtrime</i>).
	13.	Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën(<i>ushtrime</i>).
	14.	Diktim.
	15.	Poezi për fëmijërinë.
	16.	Sinonimet (<i>fjalët me kuptim të njëjtë</i>). Antonimet (<i>fjalët me kuptim të kundërt</i>). Fjalët me shumë kuptime.
	17.	Tekst jo letrar për sportin dhe fëmijët.
	18.	Tekst jo letrar për sportin dhe fëmijët.
	19.	Tekst jo letrar (<i>shkrim reviste për mjedisin</i>).
	20.	Shkruajmë një tregim imagjinar.

Matematikë

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Njësitë e matjes së kohës <i>sekonda, minuta, ora</i> . Ora me akrepa.
	2.	Matja e kohës <i>dita, muaji, viti</i> . Përdorimi i kalendarit. Tabela e orareve.
	3.	Krahasimi i dy thyesave me emërues të njëjtë. Renditja e thyesave me emërues të njëjtë.
	4.	Formimi i thyesave të barabarta. Pjesa e një numri.
	5.	Numrat dhjetorë. Leximi dhe shkrimi i numrave dhjetorë.
	6.	Vlera dhe vendvlera e shifrës të numrat dhjetorë me dy shifra pas presjes.
	7.	Kalimi nga thyesa në numër dhjetor.
	8.	Renditja e thyesave dhe numrave të përzier në boshtin numerik.
	9.	Njësitë standarde të matjes së gjatësisë <i>km, m, cm, kg, g</i> . Numrat dhjetorë gjatë matjeve.
	10.	Këmbime me njësi të ndryshme.
Java II	11.	Vëllimi i lëngjeve. Leximi i enëve të shkallëzuara.
	12.	Njësitë e matjes së vëllimit të lëngjeve <i>litri, mililitri</i> .
	13.	Numrat negativë. Leximi i termometrit.
	14.	Numrat negativë në boshtin numerik. Krahasimi i numrave negativë.
	15.	Vargjet numerike me të gjitha llojet e numrave.
	16.	Dallimi i ligjësisë dhe vazhdimi i një modeli.
	17.	Kuptimi për raportin. Kuptimi për përpjesëtimin.

	18.	Lëvizja dhe pozicioni. Drejtimi orar dhe kundërorar.
	19.	Grumbullimi, zbulimi dhe klasifikimi i të dhënave në një listë ose tabelë. Tabela e dendurive.
	20.	Diagramet në shtyllë. Intervallet në diagramet në shtyllë. Diagrami i Venit.

6.5.Klasa e pestë

Gjuhë shqipe

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Tregim
	2.	Analiza e tregimit (<i>Mjedisi, koha, personazhet</i>)
	3.	Përemri pronor.
	4.	Përemri pyetës (<i>Kush, cili, çfarë, ç', sa</i>). Përemri dëftor.
	5.	Poezi e poetëve shqiptarë.
	6.	Poezi e poetëve shqiptarë.
	7.	Zgjedhimi në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer, në mënyrën dëftore, i foljeve: <i>marr, dal, jap</i> dhe <i>shoh</i> .
	8.	Zgjedhimi në kohën e kryer të thjeshtë, në mënyrën dëftore, i foljeve: <i>marr, dal, jap</i> dhe <i>shoh</i> .
	9.	Tregim për kohën e lirë (<i>Lojërat dje dhe sot</i>).
	10.	Analiza e tregimit (<i>Mjedisi, koha, personazhet</i>).
Java II	11.	Punë me shkrim (<i>Ndjenjat e përjetuara gjatë lojës</i>).
	12.	Punë me shkrim (<i>Ndjenjat e përjetuara gjatë lojës</i>).
	13.	Shkrimi i datave. Diktim.
	14.	Tekst jo letrar.
	15.	Tekst jo letrar.
	16.	Shkruajmë një intervistë të thjeshtë drejtuar një të afërmi, si: gjyshes, shokut, mësuesit etj.
	17.	Tekst dramatik
	18.	Analiza e tekstit dramatik (<i>personazhet, dialogu</i>)
	19.	Gjymtyrët kryesore.
	20.	Gjymtyrët e dyta. Përcaktori.

Matematikë

JAVA	NR.	TEMAT MËSIMORE
Java I	1.	Thyesat e barabarta. Thyesat më të vogla se një dhe më të mëdha se një.
	2.	Kthimi i thyesave të parregullt në numra të përzier. Thyesa të thjeshtueshme e të pathjeshtueshme.

	3.	Pjesa e një numri. Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të përbashkët.	
	4.	Matja e kohës me sistemin 24- orësh. Ora digjitale. Tabela e orareve, intervalet. Kalendarari.	
	5.	Simetria. Drejtëza simetrike. Figurat simetrike.	
	6.	Rrjeti koordinativ. Koordinatat.	
	7.	Simetria në rrjetin koordinativ.	
	8.	Zhvendosja paralele.	
	9.	Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta).	
	10.	Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt.	
	Java II	11.	Mbledhja dhe zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtën numër shifrash pas presjes.
		12.	Barazimi ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë.
13.		Thyesat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzier. Renditja e numrave të përzier në një bosht numerik.	
14.		Lidhja e thyesës me pjesëtimin. Thyesa si raport ose pjesëtim i thjeshtë.	
15.		Numrat pozitivë dhe negativë në boshtin numerik.	
16.		Renditja dhe krahasimi i numrave pozitivë dhe negativë në boshtin numerik.	
17.		Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektsh sipas një ose dy cilësive të përbashkëta.	
18.		Diagramet në shtyllë. Intervalet në diagramet në shtyllë. Piktogrami dhe tabela e dendurive.	
19.		Gjetja e modës. Grafikët me vija. Ndërtimi i një grafiku të thjeshtë me vija.	
20.		Probabiliteti. Mundësitë që të ndodhë një ngjarje.	

7. Metodologjia për zbatimin e temave mësimore të programit plotësues

Gjatë zbatimit të programit plotësues, mësuesi duhet të bashkëveprojë me nxënësit gjatë procesit mësimor si kusht për arritjen e rezultateve të të nxënit, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Si në lëndën e gjuhës shqipe, edhe në matematikë, mësuesi ka mundësi të përdorë metoda dhe teknika të larmishme mësimdhënieje, të cilat nxisin të menduarit dhe aftësitë krijuese të nxënësit. Në kushtet e programit plotësues, përdorimi i metodave dhe i teknikave të ndryshme: lehtëson të kuptuarit e përmbajtjes, të ideve dhe të zgjidhjeve; shërbejnë për çdo formë të organizimit të orëve mësimore, si në punë individuale, ashtu edhe në punë në grupe dyshe, katërshje e më gjerë; i përfshijnë nxënësit në të gjitha proceset e të menduarit, nga njohja dhe të kuptuarit të gjërave

në analizën, vlerësimin, argumentimin dhe mbajtjen e një qëndrimi të caktuar; u krijojnë mundësi nxënësve për fitimin e shprehive të zgjidhjes së problemeve dhe mund të përdoren prej tyre edhe në kryerjen e detyrave në mënyrë të pavarur.

Ndër metoda dhe teknikat që shërbejnë për të dyja lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Matematikë”, përmendim:

Teknikën e parashikimit me terma paraprakë

Kjo teknikë i nxit fëmijët të mendojnë rreth ngjarjes që mund të krijohet me termat e dhënë paraprakisht dhe i motivon për të qenë të interesuar për temën e re të mësimin.



Mësuesi përcakton (zgjedh) 4-5 terma kryesorë, të cilat mund të jenë fjalë, shprehje, numra, simbole) dhe kërkon prej nxënësve të shkruajnë rreth pyetjeve:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë sapo të dëgjoni këto fjalë?
- Cilat janë veprimet që mund të kryejmë me këta numra?
- Cila mund të jetë figura që krijohet duke kombinuar këto forma?
- Si mund t'i paraqesim në tabelë këto të dhëna? Etj.

Secili nxënës shkruan në fletore variantin e tij. Nxënësit mund ta diskutojnë punën me fëmijët e tjerë të klasës. Mësuesi dëgjon përgjigjet e nxënësve, duke mbajtur ndërkohë edhe shënime. Mbajtja e shënimeve nga ana e mësuesit është një element i rëndësishëm, pasi nxënësit kuptojnë se puna që kryejnë kërkon seriozitet dhe do të dëgjohet me vëmendje nga shokët dhe nga mësuesja. Kjo teknikë shërben shumë mirë për zhvillimin e aftësive të të shprehurit, me shkrim dhe me gojë, për të menduarit dhe krijimin sipas një skeme të caktuar logjike.

Më tej, kjo teknikë mund të vijojë me **tabelën e parashikimeve**, nëpërmjet të cilës nxënësit “ballafaqojnë” parashikimet dhe mendimet që japin me variantin e autorit/ mësuesit. Zgjidhen tema përmbajtja e të cilave ka në qendër një problem, një personazh, ose një ngjarje që ndryshon papritur rrjedhë. Tabela e parashikimeve ka formën e mëposhtme:

Ç'mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Për të plotësuar tabelën, mësuesi bën pyetje që kërkojnë nga nxënësit të parashikojnë se ç' mund

të ndodhë, të lexojnë me kujdes pjesën (problemën ose situatën problemore), pasi nga ajo do të nxjerrin provat për parashikimin që bëjnë dhe të krahasojnë parashikimin me atë që ka ndodhur në të vërtetë. Këto janë pyetje që nxitin nivelin e lartë të të menduarit. Ato u drejtohen nxënësve në ndalesën e çdo paragrafi.

Disa prej këtyre pyetjeve do të shihen në shembullin e mëposhtëm.

- *Për çfarë mendoni se bën fjalë tregimi/ përralla/ historia? Cili do të jetë problemi? Pse mendoni kështu?*
- *Po tani ç' mendoni? A u çuditët? Ç' mendoni rreth...?*
- *A do të zgjidhet problemi? Nëse po, si?*
- *Ç' mendoni rreth zgjidhjes që ka dhënë autori? A do të ecë ajo? Pse po, ose jo?*
- *Çfarë do të mendonit po të ishit në vend të...? Çfarë mendon vetë personazhi?*
- *Po tani në fund që problemi u zgjidh çfarë mendoni? Si mendoni ju se ndjehen të gjitha personazhet?*

Mësuesi bën përshtatjen e teknikës, në rast se do ta përdorë në lëndën e matematikës.

<i>Cilat janë të dhënat? Çfarë mund të gjejmë me to?</i>	<i>Pse mendoni kështu?</i>	<i>Çfarë gjetëm në të vërtetë?</i>

Ruaje fjalën e fundit për mua

Mësuesi e përdor këtë teknikë kur do të aktivizojë sa më shumë nxënës në orën e mësimit, kur kërkon të zbulojë mendimet, ndjenjat dhe qëndrimet e tyre për fragmente të ndryshme të tekstit dhe kur do të krijojë një atmosferë të larmishme.

Realizimi i teknikës “Ruaje fjalën e fundit për mua” kalon nëpër disa hapa dhe ka disa rregulla.

- Gjatë leximit të një pjese nxënësit duhet të gjejnë një ose më shumë pjesë që sipas tyre janë interesante dhe rreth të cilave ia vlen të diskutohet.
- Pjesa e zgjedhur shkruhet në një skedë bashkë me numrin e faqes prej të cilës është shkëputur.
- Në anën e pasme të skedës shkruhet një koment për citatin. Nxënësit mund të shkruajnë se nuk janë dakord me diçka që është shkruar në tekst, mund ta përpunojnë apo të zgjedhin çfarë të duan.
- Një nxënës lexon me zë të lartë fragmentin e zgjedhur. Mësuesi u kërkon nxënësve të tjerë që kanë zgjedhur po këtë fragment, të bëjnë komentet përkatëse. Duhet bërë kujdes që

diskutimi të përqendrohet atje ku duhet. Edhe mësuesi mund të bëjë koment mbi pjesën e lexuar.

- Për ta mbyllur diskutimin mësuesi fton nxënësin që bëri zgjedhjen e pjesës ta lexojë me zë të lartë komentit e tij. Ky është sekreti: Diskutimi përfundon këtu. *Nxënësi që e ka zgjedhur ka të drejtën ta thotë fjalën i fundit.*

- Mësuesi fton një nxënës tjetër që të lexojë pjesën e tij të preferuar dhe e fillon diskutimin e ri nga e para.

- Gjatë leximit të një pjese nxënësit duhet të gjejnë një ose më shumë pjesë që sipas tyre janë interesante dhe rreth të cilave ia vlen të diskutohet.

- Pjesa e zgjedhur shkruhet në një skedë bashkë me numrin e faqes prej të cilës është shkëputur.

- Në anën e pasme të skedës shkruhet një koment për citatin. Nxënësit mund të shkruajnë se nuk janë dakord me diçka që është shkruar në tekst, mund ta përpunojnë apo të zgjedhin çfarë të duan.

- Një nxënës lexon me zë të lartë pasazhin e zgjedhur. Mësuesi u kërkon nxënësve të tjerë që kanë zgjedhur po këtë pasazh, të bëjnë komentet përkatëse. Duhet bërë kujdes që diskutimi të përqendrohet atje ku duhet. Edhe mësuesi mund të bëjë koment mbi pjesën e lexuar.

- Për ta mbyllur diskutimin mësuesi fton nxënësin që bëri zgjedhjen e pjesës ta lexojë me zë të lartë komentit e tij. Ky është sekreti: Diskutimi përfundon këtu. *Nxënësi që e ka zgjedhur, ka të drejtën ta thotë fjalën i fundit.*

- Mësuesi fton një nxënës tjetër që të lexojë pjesën e tij të preferuar dhe e fillon diskutimin e ri nga e para.

Nëse mësuesi e përdor këtë teknikë në lëndën e matematikës atëherë do të bëjë përshtatjen e duhur. "Ruaje fjalën e fundit për mua" mund ta përdoret për zbatimin e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit, për zhvillimin e kompetencës së arsyetimit dhe të vërtetimit matematik etj.

Stuhia e mendimeve

Stuhia e mendimeve është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështjeje dhe të tregojnë gjithçka dinë rreth saj. Ata nuk shqetësohen nëse idetë që u vijnë në mendje janë të drejta ose të gabuara. Nxënësit duhet të shkruajnë brenda kohës që u ka lënë në dispozicion mësuesi çdo gjë që dinë rreth temës në fjalë.

Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë, që mbështetet në një pyetje binare, që kërkon përgjigje pozitive ose negative dhe që prek direkt thelbin e çështjes apo të problemit.

Po	Jo	Nxënësit shkruajnë një listë me arsye se pse janë pro, ose kundër çështjes/problemit dhe i shënojnë në organizuesin grafik. Më pas mendimet do t'i shkëmbejnë në dyshe, në katërshe dhe në gjysma klasash dhe do të përcaktojnë pozicionin që do të mbajnë. Pasi nxënësit kanë përcaktuar pozicionin e tyre bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur pro ose kundër çështjes/ problemit.
Këtu shkruhet pyetja për çështjen kryesore		


Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsye më bindëse.

Pema e mendjes

Pema e mendjes është një metodë që i nxit nxënësit të mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje, si dhe i bën ata të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve të dhëna. Metoda shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të shkruarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizimin e kësaj metode janë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u mbajtur mend:

- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës/ tabelës.
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Kur idetë vijnë në mend dhe shkruhen, fillohet të lidhen idetë me njëra - tjetrën.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për sforcimet në shkrim apo shqiptim.



Di/ Dua të di/ Mësova më shumë paraqitet në formën e tabelës së mëposhtme:

Di	Dua të di	Mësova më shumë

Në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket i njohur; në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje ose kërkesa të nxënësve rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër; në kolonën e tretë, “Mësova më shumë”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti.


Ditari dypjesësh

Ditari dypjesësh përdoret për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme dhe të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e veta.

Pjesa	Komenti

Për të bërë ditarin dypjesësh, hiqet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit që i tërheqin më shumë vëmendjen nxënësit, ndoshta ato që u kujtojnë diçka ose që i intrigojnë më shumë ose ndoshta ato mendime dhe opinione me të cilat ata nuk pajtohen. Në anën e djathtë të fletës shkruhen komente për pjesën.

Kubimi



Kubimi është një metodë që ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruar in në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa, të cilat i përkasin çdo niveli pyetjesh: *Përshkruaj, Krahaso, Shoqëro, Analizo, Zbato, Argumento (pro ose kundër)*.

Në fillim paraqitet tema. Më pas nxënësit udhëzohen të mendojnë dhe:

- Të përshkruajnë: *Ç' formë ka? Cilat janë përmasat? Ç' ngjyrë ka?*
- Të krahasojnë: *Me kë ngjason? Nga se ndryshon?*
- Të rikujtojnë ndonjë ngjarje a histori: *Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?*
- Të analizojnë: *Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?*
- Të zbatojnë në një situatë a kontekst të ri: *Ç'mund të bëni me të? Si mund të përdoret?*

- Të mbajnë një qëndrim të argumentuar: *Cili është qëndrimi juaj? Pse?*


Duke vazhduar periudhën e shkrimit, nxënësit lexojnë dhe shkëmbejnë përgjigje për secilën faqe të kubit. Veprimtaria mund të organizohet në punë individuale, në çifte ose në grup.

Pesëvargëshi

Pesëvargëshi është një “*poemë*”, e cila kërkon sintetizimin e informacionit dhe të materialeve dhe një shprehje të saktë, e cila përshkruan apo reflekton idenë kryesore të një teme të caktuar.

Pesëvargëshi ka këtë strukturë

- Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (*zakonisht emër*).
- Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (*dy mbiemra*).
- Rreshti i tretë përmban tri fjalë që shprehin veprime të temës (*tri folje*).
- Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë që shpreh qëndrimin/ndjenjën për temën (*fjali*).
- Rreshti i fundit është një fjalë sinonime që përcakton thelbin e temës (*sinonim*).




Nxënësit do të shkruajnë brenda kohës që u lë në dispozicion mësuesi.

Diagrami i Venit

Diagrami i Venit është një teknikë me anën e të cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy temave, personazheve, fjalëve të urta, ngjarjeve, përrallave, vjershave etj. Dy pyetjet mbi të cilat ndërtohet diagrami i Venit janë:

- *Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet ...?*
- *Cilat janë ndryshimet ndërmjet tyre?*




Diagrami i Venit ndërtohet me ndërprerjen e dy a më shumë rrathëve. Ai mund të përdoret për të bërë krahasimin e ideve duke treguar njëkohësisht të përbashkëtat që ato kanë me njëra - tjetrën.

Dora e fshehtë

Materiali ndahet në disa pjesë. Grupet e nxënësve do të kenë aq anëtarë sa pjesë të shkëputura krijon mësuesi. Çdo nxënës i jepet një prej këtyre copëzave dhe i lihet kohë e mjaftueshme që ai të lexojë, të kuptojë përmbajtjen e saj dhe të jetë në gjendje t'u flasë shokëve për të. Pasi raportojnë të gjithë anëtarët e grupit, nxënësit do të punojnë për të renditur në mënyrën më të përshtatshme copëzat që kanë.

Ata duhet ta rishikojnë renditjen që kanë bërë, të bëjnë pyetje dhe diskutime derisa të arrijnë në përfundimin se kjo që bënë ishte renditja përfundimtare e materialit.



Analiza e tipareve semantike

Analiza e tipareve semantike i ndihmon nxënësit në përmbledhjen e njohurive dhe të informacioneve sipas modelit të tabelës së mëposhtme.

Kategoritë	Tiparet krahasuese						
	Ka gjini	Ka numër	Ka trajtë	Ka rasë	Lakohet	Zgjedhohet	...
Emri							
Mbiemri							
Folja							
Përemri							
Ndajfolja							
...							

Kategoritë	Tiparet krahasuese						
	Ka tri brinjë	Ka katër brinjë	Ka katër kulme	Ka dy drejtëza simetrie	Ka katër drejtëza simetrie	Ka dy diagonale	Nuk ka...
Katrori							
Trekëndësi							
Drejtëndëshi							
Paralelogrami							
Trapezi							
...							

Teknika për zhvillimin e aftësive

Matematika i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë dhe shprehitë e të menduarit në mënyrë që të analizojnë në mënyrë kritike rreth informacionit që ata i rrethon në jetën e përditshme. Përpunimi i informacionit i ndihmon më shumë nxënësit të kenë njohuri të qëndrueshme, sesa ta mësojnë atë dhe ta pranojnë thjesht si mendim të dikujt tjetër. Aftësia për të menduar në mënyrë kritike mund të mësohet në mënyrë efektive edhe nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme:

- ✗ Çfarë vëreni /shihni /gjeni?
- ✗ Cilat janë dallimet ndërmjet...?
- ✗ Çfarë ngjashmëri keni ju me...?
- ✗ Cilat elemente i takojnë këtij grupi...? Pse?
- ✗ Pse këto nuk i përkasin këtij grupi...?
- ✗ Çfarë mund të kishte ndodhur nëse...?
- ✗ Çfarë do të sugjeronit në qoftë se...?
- ✗ Si do ta përmbledhje...?
- ✗ Çfarë shpjegimi do të jepni për...?
- ✗ A është gjithmonë kështu...? Pse?
- ✗ A ka dëshmi për...?
- ✗ Si mund të testohet/kontrollohet...?
- ✗ Mendoni çfarë do të ndodhte nëse...?
- ✗ Çfarë ju bën të mendoni se kjo... do të ndodhte?
- ✗ Çfarë do të duhej që kjo... të ndodhte?
- ✗ A ka ndonjë shpjegim tjetër?
- ✗ Nëse... ndodh, çfarë do të ndodhë më pas? etj.

“Plotësimi i mesazhit”

Shembull

Janë dhënë dy tabela. Në tabelën A janë vendosur mbledhja dhe zbritja e numrave dy – treshifrorë dhe për secilën prej tyre është vendosur një fjalë.

Tabela A

56 + 64 Gjithmonë	123 - 17 E	85 + 135 Udhëzimet	935 - 187 Nxënësi
850 + 64 Tij	652 - 234 Dëgjon	67 - 37 Mësuesit	36 + 74 Të

Në tabelën B janë vendosur rezultati i veprimit. Nxënësi do të vendosë fjalën në vlerën e duhur. Çfarë mesazhi krijuat?

Tabela B

748 Nxënësi	418 Dëgjon	120 Gjithmonë	220 Udhëzimet
106 E	28 Mësuesit	110 Të	914 Tij

Nxënësit mund të krijojnë vetë dy tabela të tjera dhe të vendosin fjalë për të krijuar një mesazh. Nxënësit kryejnë vetëvlerësim nëse mesazhi ka dalë i qartë ose vlerësim të njëri – tjetrit, duke gjykuar mbi punën që ka bërë shoku.

Lojëra për të nxënë

Lojërat mësimore për të nxënë janë aktivitete që përfshijnë nxënësit në përvoja të simuluar për të zhvilluar koncepte dhe aftësi, për të regjistruar informacione ose për të demonstruar kompetencat. Lojërat mësimore mund të bëhen nga mësuesit ose nga nxënësit. Për shembull, nxënësit mund të krijojnë një lojë dhe ta realizojnë në klasë.

Shembull

Lojë me numrat e plotë

Në një letër vizatojmë tabelën e lojës siç tregohet në figurë.

	-10	-9	-8	-7	-6	-5	-4	-3	-2	-1	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
--	-----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	--

Përgatishim dy zare kubikë me 6 numra. Njëri zar ka numrat pozitivë 1, 2, 3, 4, 5, 6, ndërsa zari tjetër ka numrat -1, -2, -3, -4, -5, -6.

Rregullat e lojës:

- Loja luhet me dy lojtarë, lojtari A (negativ) dhe lojtari B (pozitiv).
- Loja fillon në 0.
- Hidhen të dyja zaret njëkohësisht për të parë se kush e fillon lojën i pari. Personi që grumbullon më shumë pikë nga zaret fillon lojën i pari. P.sh., lojtari A ka 5 dhe -3, ndërsa lojtari B ka 4 dhe -1. Atëherë lojtari B fillon lojën i pari.
- Loja luhet me radhë nga secili lojtar duke hedhur të dyja zaret.
- Secili lojtar lëviz në tabelë sipas pikëve të grumbulluara gjatë hedhjes së zareve në radhën e tij. P.sh. $-3 + 2 = -1$ lojtari lëviz një kuti majtas (negative). $3 + -1$ lojtari lëviz 2 kuti djathtas.
- Lojën e fiton kush mbërrin i pari te 10 ose -10.

Palosja e letrës

Jepini secilit nxënës një fletë formati A4. Paloseni një herë. Sa pjesë formohen?

Paloseni përsëri edhe njëherë. Sa pjesë formohen?

Paloseni përsëri edhe njëherë. Sa pjesë formohen?

Plotësoni tabelën. Shikoni me kujdes. Pa kryer palosjet gjeni numrin e pjesëve që mund të krijohen kur e palosni fletën 4 herë, 5 herë.

Numri i palosjeve	1	2	3	4	5
Numri i pjesëve	2				

Kush gjen më shpejt numrin e pjesëve nëse fleta paloset: 6 herë, 7 herë, 8 herë, 9 herë, 10 herë.

Çfarë konkluzioni ka nxjerrë secili nxënës?

Konkurset

Konkurset, në përgjithësi, konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e shkollës kryesisht për nxënësit shumë të mirë dhe të talentuar. Konkurset përdoren më së shumti për të demonstruar aftësi fizike dhe sportive të ndjekura nga aftësi intelektuale/akademike.

Në fakt, *në këtë udhëzues konkurset do t'i shohim si teknikë mësimdhënieje* për të ushtruar strategjitë e veprimeve me mend. Ky lloj konkursi i ofrohet të gjithë nxënësve për të konsoliduar veprimet matematikore dhe u jep mundësi atyre për të përmirësuar arritjet personale në lëndën e matematikës. Konkursi shikohet si një teknikë e procesit të nxënies për sigurimin e një mjedisi inkurajues dhe motivues në të cilin të gjithë nxënësit konkurrojnë duke rritur aftësitë e të nxënësve si dhe ndjenjën e autonomisë.

Qëllimet kryesore të konkurseve në klasë në lëndën e matematikës janë rritja e motivimit, emocioneve dhe interesimit në matematikë. Përgatitja për një konkurs në matematikë mund të kërkojë studim të pavarur, pasi shumë konkurse kërkojnë përgjigje të shpejta dhe të sakta nën presion.

Është e rëndësishme të theksojmë që konkursi mund të drejtohet, të zhvillohet dhe të vlerësohet nga vetë nxënësit.

8. Mjetet mësimore

Për zhvillimin e programit plotësues mund të përdoren tekstet mësimore të gjuhës shqipe dhe të matematikës, me të cilat kanë punuar nxënësit gjatë vitit shkollor 2019-2020. Në procesin e të nxënësve mund të përdoren materiale nga interneti, libra nga biblioteka e shkollës, fletë pune, udhëzues të ndryshëm etj. Këto materiale duhet të jenë të qarta, të sakta, me një gjuhë të kuptueshme, në përputhje me programin dhe nuk duhet të krijojnë mbingarkesë për nxënësit.

9. Dokumentacioni për frekuentimin dhe arritjet e nxënësve

Shkollat janë të lira të përcaktojnë vetë një miniregjistër, ku të shënojnë emrat e nxënësve që do të marrin pjesë në programin plotësues, mungesat, temën, si dhe ndonjë shënim për arritjet e nxënësve. Në përfundim të programit plotësues, mësuesi e dorëzon këtë miniregjistër në drejtorinë e shkollës.

Gjatë zbatimit të programit plotësues *nuk do të ketë vlerësim me notë të nxënësve*. Megjithatë gjatë gjithë procesit mësimor dyjavor, mësuesi do t'i motivojë nxënësit për të përmirësuar të nxënësve e tyre.

Në përfundim të programit plotësues, drejtorja e shkollës informon me një raport të shkurtër ZVA-në dhe DRAP-in, në lidhje me ecurinë e zbatimit të programit dhe numrin e nxënësve që e kanë ndjekur atë.